



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KOMISIONERI PËR TË DREJTËN E INFORMIMIT DHE MBROJTJEN E TË
DHËNAVE PERSONALE

DREJTORIA PËR TË DREJTËN E INFORMIMIT

Nr. 805/1 Prot

Tiranë, më 7 / 8 / 2020

VENDIM

Nr. 37, datë 7 . 8 . 2020

PËR

URDHËRIMIN E AUTORITETIT PUBLIK

Në mbështetje të nenit 23 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, pikës 3 dhe 5 të nenit 24, të ligjit nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit”, shkronjës a) të nenit 31/1 të ligjit nr. 9887 datë 10.03.2008 “Për mbrojtjen e të dhënave personale” i ndryshuar,

KONSTATOVA SE:

Ankuesi, z. (në vijim “ankuesi”) ka depozituar pranë Zyrës së Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale (në vijim “Komisioneri”) ankesën nr. 805 Prot., datë 01.07.2020, me objekt “*Ankim ndaj refuzimit për dhënie informacioni dhe kopje të dokumenteve zyrtare*”, kundër Autoritetit Publik/Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë (në vijim “Autoriteti Publik”).

Ankuesi, nëpërmjet kërkesës së datës 03.06.2020, depozituar në adresën e koordinatorit për të drejtën e informimit Etleva.Shore@infrastruktura.gov.al, ka kërkuar t’i vihet në dispozicion informacioni dhe dokumentacioni në lidhje me Parkun (140 MW) e paneleve fotovoltaike në Karavasta, duke përfshirë dokumentacionin e disponueshëm, si vijon:

1. Listën emërore të Komisionit të konkursit që shpalli fituesin e ankandit, pozicionin (ekspertizën) e secilit anëtar të Komisionit, si dhe formimin e tyre profesional (psh.: nëse ka qenë inxhinier, çfarë lloj inxhinieri, jurist apo ekonomist);
2. Studimin e fizibilitetit të hartuar për këtë koncesion (sipas kriterëve të përcaktuara në Ligjin për Koncesionet dhe Partneritetin Publik Privat);
3. Lista e kompanive (të pesta) pjesëmarrëse të përzgjedhura pas fazës së parë;
4. Hartën (koordinatat) ku do të zhvillohet projekti;
5. Raportin përfundimtar vlerësues të KVO-së, dorëzuar pas përmbylljes së këtij ankandi.

Me pretendimin se është cënuar në të drejtën për informim, ankuesi ka paraqitur ankimin nr. 805 Prot., datë 01.07.2020 pranë Komisionerit duke i kërkuar ushtrimin e kompetencave që i njeh ligji për rastet e refuzimit të dhënies së informacionit.

Komisioneri pas shqyrtimit paraprak të ankesës, bazës ligjore dhe rrethanave të faktit të paraqitura në të, vlerësoi se ankesa përmbush kriteret formale ligjore, të përcaktuara në nenin 24 të ligjit nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit”.

Në ndjekje të procedurës për shqyrtimin administrativ të çështjes, si hap paraprak përpara marrjes së vendimit, në përputhje me nenin 10 të ligjit nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”, i cili parashikon: “*Organi publik siguron që të gjitha palët dhe persona të tjerë të përfshirë në procedurë të jenë në gjëndje të ndjekin dhe të mbrojnë të drejtat dhe interesat e tyre ligjorë në mënyrë sa më efektive dhe të lehtë të jetë e mundur*”, Zyra e Komisionerit, me shkresën nr. 805/1 prot., datë 08.07.2020 ka kërkuar nga Autoriteti Publik vlerësimin e dhënies së informacionit, duke i lënë kohë për kthimin e përgjigjes deri më datë 13.07.2020.

Në tejkalim të këtij afati, me Urdhrin nr. 128, datë 17.07.2020, Komisioneri vendosi fillimin e hetimit administrativ pranë Autoritetit Publik, me qëllim verifikimin e fakteve dhe rrethanave, që mund të jenë bërë pengesë për vënien në dispozicion të informacionit të kërkuar.

Me e-mail-in datë 17.07.2020, koordinatoresha për të drejtën e informimit ka informuar ankuesin duke bërë me dije dhe Zyrën e Komisionerit se: “*Në vijim të ankesës të paraqitur pranë Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale, Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë ka përgatitur përgjigjen me informacionin dhe dokumentacionin e kërkuar dhe përgjigja do të dërgohet në rrugë zyrtare nëpërmjet postës*”.

Në mungesë të përgjigjes u vijua me inspektimin pranë Autoritetit Publik, ku u depozitua urdhri i inspektimit administrativ dhe u protokollua me nr. 5473 Prot., datë 20.07.2020.

Në ndjekje të procedurës, u kontaktua me koordinatoren e së drejtës për informim, në cilësinë e pikës së kontaktit dhe personit përgjegjës në kuptim të ligjit nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit”, për t’u informuar lidhur me shkaqet dhe arsyet që janë bërë pengesë për vënien në dispozicion të informacionit të kërkuar, e cila parashtroi ndër të tjera se: “*Ndodhur në kushte pune tepër specifike, me një staf të reduktuar për shkak të pandemisë, përgjigja përfundimtare së bashku me dokumentet që iu bashkëlidhën kësaj përgjigje i është dërguar kërkuesit me shkresën nr. 5161/1 Prot., datë 17.07.2020*”.

Gjithashtu, koordinatoresha sqaroi se, në vijim të përgjigjes së dërguar me postë, ankuesit i është dërguar informacioni i kërkuar edhe me emailin datë 22.07.2020, si më poshtë:

“Komisioni i Posaçëm për zhvillimin e Procedurës i ngritur me Urdhrin Nr. 336/1, datë 20.12.2019 të Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë “Për ngritjen e Komisionit të

Posaçëm për përzgjedhjen e projektit që do të përfitojë nga masat mbështetëse për ndërtimin e Impiantit Fotovoltaik në zonën e Karavastasë”, përveç detyrave për hartimin e dokumentacionit të procedurës konkurruese dhe ndjekjes së procedurës, aktualisht po trajton edhe negociimin e kontratës finale me shoqërinë fituese Voltalia.

Duke qenë se kjo procedurë është akoma në ndjekje dhe palët janë ende duke negociuar për të finalizuar kontratën finale, jemi të mendimit që jemi para rasteve përjashtuese/kufizuese të ligjit për të drejtën e informimit. E theksojmë se, kjo kontratë është akoma në fazë diskutimi brenda autoritetit publik dhe për këtë arsye informacioni nuk mund të jetë i plotë për sa i përket dhënies së emrave të anëtareve të tij (pjesa tjetër e informacionit dhe e dokumentacionit duke përfshirë edhe procesverbalet është dërguar nëpërmjet postës)”.

Ankuesi, duke e konsideruar të paplotë përgjigjen e dhënë nga Autoriteti Publik, me email-in e datës 24.07.2020, ka vijuar ankimin lidhur me pikën e parë të kërkesës për informacion, me pretendimin se mospublikimi i emrave të Komisionit të Posaçëm, keqinterpreton kufizimin e parashikuar në ligjin nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit”.

Pas konsultimit të legjislacionit përkatës dhe dokumentacionit të administruar gjatë procesit të hetimit administrativ, Komisioneri kontaton se, Autoriteti Publik ka kthyer përgjigje në lidhje me pikat 2, 3, 4 dhe 5 të kërkesës për informacion datë 03.06.2020, konfirmuar kjo edhe nga ankuesi nëpërmjet e-mail-it datë 24.07.2020.

Ndërsa, për pikën 1 të kërkesës së sipërcituar, ka refuzuar vënien në dispozicion të informacionit, me argumentin se: “...është para rasteve përjashtuese/kufizuese të ligjit për të drejtën e informimit, pasi kjo kontratë është akoma në fazë diskutimi brenda autoritetit publik dhe për këtë arsye informacioni nuk mund të jetë i plotë për sa i përket dhënies së emrave të anëtareve të tij...”, argument ky i cili rezulton i pabazuar në ligj.

Në frymën e pikës 6 të nenit 17 të ligjit nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit”, sipas të cilit “Nëse kufizimi prek vetëm një pjesë të informacionit të kërkuar, pjesa tjetër nuk i refuzohet kërkuarit. Autoriteti Publik tregon qartë pjesët e dokumentacionit përkatës që janë refuzuar, si dhe në bazë të cilës pikë të këtij neni është bërë ky refuzim”, Autoriteti Publik, duhet të kishte saktësuar dhe argumentuar se në bazë të cilës pikë të nenit 17 “Kufizime” të ligjit të sipërcituar është refuzuar e drejta për informim.

Gjithashtu, Komisioneri vlerëson se kërkesa lidhet me të dhëna punonjësish të administratës publike në kuadër të ushtrimit të detyrës së tyre dhe për rrjedhojë ky informacion duhet vënë në dispozicion, pasi gjen zbatim shkronja b) e pikës 4, të nenit 4, të ligjit nr. 9887, datë 10.03.2008 “Për mbrojtjen e të dhënave personale”, i ndryshuar, në të cilin parashikohet se: “Ky ligj nuk zbatohet për përpunimin e të dhënave vetëm për rastet kur jepet informacion për persona publik zyrtarë ose punonjës të administratës publike (shtetërore), nëpërmjet të cilit pasqyrohet aktiviteti publik, administrativ ose çështje lidhur me detyrën e tyre”.

Parashikim ky, i cili zbatohet në mënyrë proporcionale dhe në përputhje me parimin e mjaftueshmërisë së të dhënave të parashikuar në nenin 5 të ligjit të sipërcituar.

Në përfundim të shqyrtimit të ankesës dhe konsultimit të legjislacionit përkatës, Komisioneri vlerëson se, informacioni i kërkuar përmbush kërkesat e pikës 2, të nenit 2, të ligjit nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit”.

Bazuar në sa më sipër, në lidhje me ankesën e z. _____ ndaj Autoritetit Publik/Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, Komisioneri vlerëson se, duke pasur parasysh sa është parashtruar më sipër, ankesa duhet pranuar pjesërisht.

E drejta për informimin, bën pjesë në grupin e të drejtave themelore të njeriut, të mbrojtura posaçërisht nga Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë dhe Konventa Evropiane e të Drejtave të Njeriut (KEDNJ), e cila ka për qëllim t’i garantojë publikut njohjen me informacion në kuadër të ushtrimit të të drejtave dhe lirive të individit në praktikë, si dhe për ti shërbyer nxitjes së integritetit, të transparencës dhe të përgjegjshmërisë së autoriteteve publike.

Në pikën 2 të nenit 23 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë parashikohet se: *“Kushdo ka të drejtë, në përputhje me ligjin, të marrë informacion për veprimtarinë e organeve shtetërore...”*.

Ndërkohë pika 3, e nenit 3 e Ligjit nr. 119/2014 parashikon se: *“Çdo person ka të drejtë të njihet me informacionin publik, nëpërmjet dokumentit origjinal ose duke marrë një kopje të tij në formën ose formatin që mundëson akses të plotë në përmbajtjen e dokumentacionit”*.

Bazuar në nenin 15 të ligjit nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit”, *“autoriteti publik trajton kërkesën për informim brenda 10 ditëve pune nga data e dorëzimit të saj”*. Ndërkohë në pikën 1, të nenit 18 parashikohet se *mosrespektimi i dispozitave të këtij ligji, passjell përgjegjësi administrative sipas rasteve të parashikuara në pikën 2 të tij*. Në pikën 2, të nenit 18 parashikohet se *veprimet dhe mosveprimet, në përputhje me këtë ligj dhe për aq sa nuk përbëjnë vepër penale konsiderohen kundërvajtje administrative dhe dënohen me gjobë*.

E drejta për informim duhet parë e lidhur ngushtë me parimin e transparencës dhe llogaridhënies, si një shtyllë tjetër themelore e shtetit të së drejtës. Funksonimi i tyre është në interesin publik.

PËR KËTO ARSYE

Bazuar në shkronjat b) dhe ç) të pikës 5 të nenit 24, nenit 10 dhe 12 të Ligjit nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit”, shkronjën a) të pikës 1 të nenit 18 të Ligjit nr. 49/2012

“Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”, i ndryshuar,

V E N D O S A:

1. Pranimin pjesërisht të ankesës nr. 805 Prot., datë 01.07.2020 të z. _____, kundër Autoritetit Publik “Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë”, me objekt “Ankim ndaj refuzimit për dhënie informacioni dhe kopje të dokumenteve zyrtare”.
2. Urdhërimin e Autoritetit Publik, për vënien në dispozicion të informacionit në lidhje me Listën emërore të Komisionit të konkursit që shpalli fituesin e ankandit..., sipas pikës 1 të kërkesës për informacion datë 03.06.2020, brenda datës 14 . 8 .2020.
3. Kundër këtij vendimi palët kanë të drejtën e ankimit në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 45 ditëve nga marrja dijeni, sipas nenit 25 të Ligjit nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit”.
4. Ky vendim u shpall sot në datë 7 . 8 .2020.

KOMISIONERI

Besnik Dervishi

